

Lista e përjashtimit

e rifreskuar së fundmi në korrik 2020

Asnjë marrëdhënie biznesore nuk duhet të lidhet ose të mbahen me klientët e përfshirë në ndonjërin prej aktiviteteve të mëposhtme:

Praktikat dhe kushtet jo-etike të punës:

- a) Prodhimi ose aktivitetet që përfshijnë forma të dëmshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar/punës së dëmshme të fëmijëve¹, praktikat diskriminuese, ose praktikat që pengojnë punonjësit të ushtrojnë në mënyrë të ligjshme të drejtat e tyre të asociimit dhe marrëveshjes kolektive;
- b) Prodhimi ose tregtimi i lëndëve narkotike²;
- c) Prodhimi ose tregtimi i armëve (përfshirë armët e gjuetisë) dhe municionit³;
- d) Lojërat e fatit (përfshirë lojërat e fatit në internet), kazinot dhe ndërmarrjet ekuivalente⁴;
- e) Lëshimi i krypto valutave ose operimi me platforma të krypto valutave;
- f) Prostitucioni dhe çdo biznes aktiviteti primar biznesor i të cilëve ndërlidhet me pornografinë;
- g) Klinikat e riprodhimit(fertilitetit) dhe institucionet e tjera mjekësore të përfshira direkt ose indirekt në surrogaci⁵ (p.sh. përmes ndërmjetësimit ose ndonjë lehtësimiti tjetër sistematik) ose trajtim tjetër mjekësor etikisht të dyshimtë, duke përfshirë modifikimin dhe manipulimin e materialit gjenetik ose terapinë zëvendësuese mitokondriale , si dhe praktikat që ko-modifikojnë organet njerëzore.

Aktivitetet e dëmshme për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin:

- h) Prodhimi ose tregtimi ose përdorimi i fibrave të palidhura të asbestit ose produkteve që përmbajnë asbest⁷;
- i) Prodhimi ose tregtimi i produkteve që përmbajnë bifenile të poliklorinuara⁸;
- j) Prodhimi ose tregtimi i preparateve farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe substancave tjera të rrezikshme të cilat i nënshtrohen ndërprerjes ose ndalimit të prodhimit⁹;
- k) Prodhimi ose tregtimi i materialeve radioaktive (përfshirë magazinimin dhe trajtimin e mbetjeve radioaktive), biznesin ose aktivitetet që ndërlidhen me industrinë nukleare ose materialet nukleare¹⁰;
- l) Peshkimi me rrjeta rrëshqitëse në mjedise ujore duke përdorur rrjeta me gjatësi më të madhe se 2.5 km;
- m) Transporti i naftës ose i substancave të tjera të rrezikshme në cisterna që nuk janë në përputhje me kriteret e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO¹¹);
- n) Aktivitetet që përfshijnë lëshuarjen e organizmave të modifikuar gjenetikisht në mjedisin natyror pa miratimin e dhënë nga autoritetet kompetente ose kur autoriteti përkatës që e ka deklaruar veten si të lirë nga OMGJ¹²;
- o) Tregtimi i kafshëve të egra ose i produkte të kafshëve të egra të përcaktuara sipas CITES¹³;
- p) Qarkullimi ndërkufitar i mbeturinave të ndaluara sipas ligjit ndërkombëtar¹⁴;
- q) Ndërtimi i (mini-)hidrocaskadave pa vlerësimin e duhur mjedisor;
- r) Prodhimi ose tregtimi i substancave që shkatërrojnë ozonin, e që i nënshtrohen kriterëve ndërkombëtare të ndërprerjes së prodhimit¹⁵;
- s) Operacionet e prerjeve komerciale të drunjve ose blerja e pajisjeve për prerjen e drunjve për përdorim në pyjet primare me lagështi tropikale, prodhimi dhe tregtimi i drunjve ose produkteve tjera pyjore, përveç nga pyjet e menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme¹⁶;
- t) Eksploatimi i minierave të diamantëve dhe komercializimi i diamanteve, kur vendi pritës nuk i është përmbajtur marrëveshjes Kimberley (KPCS) ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme ndërkombëtare mbi burimet ekstraktive (nxjerrëse);;
- u) Minierat nëntokësore për nxjerrje të metaleve, qymyrgurit, argjilës për ekstraktim të naftës dhe mineraleve të tjera;
- v) Prodhimi i qymyrgurit me metoda të tjera nga metodat me retort (përdorimi i kontejnerëve metalik të mbyllur).

Aktivitetet që kanë ndikim negativ për komunitetin:

- w) Prodhimi ose tregtimi i çdo produkti ose aktiviteti që konsiderohet i paligjshëm sipas ligjeve, rregulloreve ose konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të vendit pritës (d.m.th. legjisllacionit kombëtar), duke përfshirë pa kufizime, legjisllacionin ose konventat lidhur me mbrojtjen e burimeve të biodiversitetit ose trashëgimisë kulturore;
- x) Aktivitetet brenda, ngjitur me ose në rrjedhën e sipërme të tokës së banuar nga popujt autoktonë dhe/ose grupet e cenushme, siç janë toka dhe burime ujore të përdorura për aktivitete jetese si për kullotjen e bagëtive, për gjueti ose peshkim;
- y) Aktivitetet të cilat mund të ndikojnë në lokalitetet me rëndësi kulturore ose arkeologjike;
- z) Aktivitetet që përfshijnë zhvendosjen e pavullnetshme.

Klientët e përfshirë në ndonjërin prej aktiviteteve të mëposhtme nuk do të financohen:

- Prodhimi ose tregtimi në sasi të mëdha i pijeve alkoolike (pa përfshirë birrën dhe verën) ;¹⁸;
- Prodhimi ose tregtimi në sasi të mëdha i duhanit¹⁹;
- Aktivitetet brenda, ngjitur ose në rrjedhën e sipërme të zonave të përcaktuara si të mbrojtura, të klasifikuara sipas IUCN në kategoritë I – IV²⁰.